

LIGJ
Nr.8433, datë 21.12.1998

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS TË
PRIVATIZIMIT TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, SHA**

(Ndryshuar me Ligjin nr. 8587, datë 15.3.2000)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, të ligjit nr.8033, datë 16.11.1995 "Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe për lejin e privatizimit të tyre" dhe të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

(Shtuar togfjalësh dhe paragraf me Ligjin nr. 8587, datë 15.3.2000)

Forma e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sha të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të saj të tretëve, nëpërmjet shitjes ose shitjes me kusht, sipas formulës së privatizimit, të parashikuar në këtë ligj.

Në rast se marrëveshja për transferimin e të drejtës së pronësisë të aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. do të bëhet me kushte, kjo marrëveshje duhet të miratohet nga Kuvendi.

Neni 2

Formula e privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, Sha të jetë si vijon:

1. Më shumë se 50 për qind e aksioneve do t'i transferohen nëpërmjet shitjes një investitori strategjik, me të cilin kuptohet një bankë, i cili do të zgjidhet nëpërmjet metodës së tenderit të hapur, ndërkombëtar.

2. Më pak se 50 për qind e aksioneve mund të ofrohen për shitje tek investitorët e tjerë, me të cilët kuptohen banka dhe institucione të tjera financiare, nëpërmjet negociatave. Kriteret për zhvillimin e negociatave caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Transferimi i së drejtës së pronësisë të aksioneve investitorëve, të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji, do të bëhet vetëm me valutë.

Neni 4

Në rast se në përfundim të procedurave, sipas nenit 2 të këtij ligji, do të mbeten aksione të patransferuara investitorëve financiarë, pronari i tyre do të jetë shteti, i përfaqësuar me këtë cilësi nga Ministria e Financave.

Ministria e Financave ka të drejtë të negociojë me investitorët e zgjedhur, sipas nenit 2 të këtij ligji, për transferimin e pjesës së mbetur të aksioneve në pronësi të shtetit ose të vazhdojë

procedurat ligjore për transferimin e tyre personave të tretë, jashtë shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit tregtar dhe bankar.

Neni 5

Investitorët që do të marrin pjesë në privatizimin dhe në blerjen e aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a. janë të detyruar të përmbushin të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe bankar i Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij ligji dhe për organizimin e procedurave të privatizimit, nëpërmjet shitjes së aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte normative në zbatim të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.2276, datë 22.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**